



QENDRA PËR NISMA LIGJORE QYTETARE

Regjistruar me vendimin nr.8/1, dt. 14.12.2004 të Gjykatës së Rrethit Tiranë
TEL.04 259795 FAX.04 241914

P.O.BOX1019 E- MAIL: avokatore2@yahoo.com

Tiranë, më 23.09.2025

TERMAT E REFERENCËS

EKSPERT/E PËR HARTIMIN E RAPORTIT MONITORUES

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka filluar zbatimin e projektit me titull “Përmirësimi i cilësisë së drejtësisë me qasje të orientuar nga mbrojtja dhe mbështetja e viktimave të dhunës seksuale, duke përdorur monitorimin dhe ndërgjegjësimin si mjete ndryshimi” në kuadër të një nën-granti të dhënë nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), si pjesë e projektit “Shoqëria civile kundër korrupsionit, nga një sfidë vendase në një përgjigje Evropiane”, mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian.

Ky projekt zbatohet në Sarandë (Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm); Lezhë (Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm) dhe Tiranë (Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm). Zbatimi i projektit do të ketë ndikim tek gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe gjyqtarët e 13 Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Në kuadrin e zbatimit të këtij projekti monitoruesit e zgjedhur kanë kryer monitorimin e vendimeve gjyqësore për nenet 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 107, 107/a, 108, 108/a, 121/a të Kodit Penal.

QNL kërkon të angazhojë një ekspert për hartimin e raportit monitorues me detyra si më poshtë vijon:

- Të kontribuojë në hartimin e strukturës së raportit, ndarjen e kapitujve dhe shkrimin e raportit të monitorimit të vendimeve gjyqësore objekt monitorimi të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë; Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- Të marrë pjesë në takimet e koordinimit me QNL për të harmonizuar gjetjet dhe stilin e raportit.
- Të kryejë një analizë të plotë të kuadrit ligjor penal që lidhet me nenet 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 107, 107/a, 108, 108/a, 121/a të Kodit Penal.
- Të shqyrtojë vendimet gjyqësore të monitoruara nga ekipi i projektit dhe të bëjë një analizë krahasuese mbi interpretimin dhe zbatimin e dispozitave përkatëse.
- Të përgatisë një kapitull mbi trendet kryesore të jurisprudencës, duke evidentuar ngjashmëritë, dallimet dhe mospërputhjet mes vendimeve të gjykatave të ndryshme.
- Të identifikojë problematika në zbatimin praktik të ligjit: vonesat procedurale, mungesat në arsyetim, respektimin e të drejtave të palëve.
- Të identifikojë rastet më përfaqësuese dhe të përgatisë përmbledhje analitike që do të përdoret si studime rasti në raport.

- Të përpunojë dhe analizojë të dhënat statistikore të mbledhura gjatë monitorimit (numri i vendimeve, llojet e sanksioneve, shkalla e dënimeve, shkalla e apeliemeve etj.).
- Të vizualizojë gjetjet përmes tabelave dhe grafikëve për ta bërë raportin më të kuptueshëm dhe të aksesueshëm.
- Të përgatisë një kapitull me konkluzione dhe rekomandime praktike, duke u bazuar si në analizën ligjore ashtu edhe në praktikën gjyqësore të shqyrtuara.
- Të ketë gadishmërinë për shpërndarjen e gjetjeve të raportit të monitorimit në rrjetet sociale dhe mediat tradicionale.
- Të bashkëpunojë me monitoruesit për çdo qartësim në lidhje me punën e bërë nga monitoruesit.
- Të respektojë afatet në zbatimin e detyrave kontraktuale.

Kualifikimet e kërkuara dhe pikëzimi në vlerësimi		
1.	Diplomë universitare e nivelit Bachelor dhe Master ose program i integruar në drejtësi ose ekuivalente me to. në Drejtësi	40 pikë
2.	Eksperiencë në tre vitet e fundit në shkrimin e raporteve në fushën e të drejtave të njeriut.	20 pikë
3.	Eksperiencë në tre vitet e fundit në monitorimin e vendimeve gjyqësore ose seancave gjyqësore dhe/ose shkrimin e raporteve monitoruese në fushën e të drejtave të njeriut.	20 pikë
4.	Ofertë financiare për një ditë pune dhe ofertë financiare për dhjetë ditë pune (në monedhën Euro)	20 pikë

Me qëllim aplikimin në këtë pozicion kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin si vijon:

1. CV e kandidatit/es;
2. Diplomë Universitare e nivelit Bachelor dhe Master ose program i integruar në drejtësi ose ekuivalente me to.;
3. Çdo dokumentacion të nevojshëm që reflekton kualifikimet e kandidatit/es dhe përvojat e mëparshme sipas pikave 2 dhe 3 në tabelën mësipër.
4. Dëshmi penaliteti;
5. Kandidati të jap të dhëna të sakta nëse është i pajisur me NUIS apo do të angazhohet si individ.

Afati i fundit i aplikimeve do të jetë data 29 shtator 2025, ora 16:00.

Dokumentacioni mund të dërgohet i skanuar në adresën e e-mail-it: avokatore2@yahoo.com ose të depozitohet pranë zyrave të Qendrës për Nisma Ligjore me adresë: Rruga “Vaso Pasha” Pll.12, Shk.1, Ap. 1 Tiranë.

Komunikimet e mëtejshme për efekt të përzgjedhjes ose jo në kuadër të kësaj thirrje do të realizohet vetëm nëpërmjet postës elektronike.